



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 170, Datë 28.06.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA
HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/3 prot., datë 23.06.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 121, datë 24.05.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit.
- Me shkresën nr. 636/1 prot., datë 06.06.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse në zbatim të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar duke shpjeguar se në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për aplikimin e ri.
- Në përgjigje të sa më sipër (brenda afatit 1-mujor të përcaktuar në rregullore), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636/2 prot., datë 10.06.2022, shoqëria ka riparaqitur kërkesën

për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacion shtesë.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërma “a”, “b”, “d”.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërma “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Shoqëria duhet të përcjellë në ERE Vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës për përfaqësuesin e saj ligjor, në bazë të nenit 7, pika 2 gërma “b” të rregullores së licencimit.**
- **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). **Shoqëria duhet të informojë ERE-n për departamentin që do të merret për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.**

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8:

- **gërmt “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve). **Shoqëria duhet të dokumentojë sasi të e parashikuara për t’u tregtuar për pesë vitet e licencës.**
- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). **Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi vlerën që do të vendosë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.**
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në vijim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 121/2022, për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower ” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI